

# **AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “PHI ACCOMODATION” SH.P.K.**

Sot më datë 20 Mars 2023, **z. Faton Daci**, i datëlindjes 28.04.1984, banues në Golem, Durrës shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë **“PHI Accomodation” sh.p.k.** si më poshtë vijon:

## **1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria **“PHI Accomodation” sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

## **2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm z. Faton Daci.

## **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **“PHI Accomodation” sh.p.k.** do të jetë:

Strukture akomoduese. Dhënie marrje me qera te ambienteve, banimi, sherbimi, parkimi. Bar - Restorant, Piceri Shërbim akomodimi ne, hoteleri, hostel, apartamente. Shit-blerje, ndërtim e rikonstruksion i pasurive të paluajtshme. Shërbime ndërmjetësie dhe konsulenca të tjera. Shërbime te lidhura me fushat e mesiperme si edhe cdo aktivitet tjetër qe nuk ndalohet nga ligji.

## **4. Selia e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë **“PHI Accomodation” sh.p.k.** do të jetë në Kryemedhenj -Kavaje, në adresën: Rruga e Gjuzëve, Zona Kadastrale 2291, Godina nr 5 .

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

## **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## **6. Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“PHI Accomodation” sh.p.k.** është 100.000 Lekë. (njqindmije)

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

## **7. Drejtimi dhe Administrimi**

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“PHI Accomodation” sh.p.k.** është **z. Faton Daci**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“PHI Accomodation” sh.p.k.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njuh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## **8. Shpërbërja dhe likuidimi**

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**Ortaku i Vetëm**

Faton Daci